

Raporti për kampin rehabilitues

Ulqini 2006

25.08.2006 – 06.09.2006



Ky është viti i gjashtë me radhe që organizohet kampi rehabilitues verorë për persona me LPK (lëndim të palcës kurrizore)që organizon Handikos- i i mbështetur nga Roberto BAZZONI

Në këtë kamp kanë qenë gjithsej 49 pjesëmarrës prej tyre :

- Paraplegjik 16
- Tetraplegjik 4
- Tetraparezë dhe Paraparezë 8
- Përcjellës 18
- Stafi ndihmës 3

Stafi udhëheqës i kapit :

Emri dhe Mbiemri

Besim Galica

Luan Çabra

Ilir Gashi

Kimete Shabani

Hajriz Muli

Peer support

Pozita

Koordinator

Ass. Koordinator

Logjistika

Motër medicinave

Vozitës

Përgjegjës për aktivitetet të kampit

Prej numrit të përgjithshëm të personave me LPK pjesëmarrës për herë të parë janë 9 persona ose 31.1%

Qëllimi i Kampit

- Krijimi i autonomisë personale dhe promovimi i jetesës së pavarur përmes rehabilitimit aktiv dhe ndarjes së përvojave jetësore mes personave me LPK

Aktivitetet sportive dhe rekreative

- Ushtrimet e mëngjesit (gjimnastika)
- Garat me karroca
- Transferet
- Përdorimi i karrocës në teren të pa përshtatshëm
- Loja e Basketbollit
- Loja ndërmjet dy zjarreve
- Loja e Shahut
- Loja e pingpongut
- Mbrëmjet argëtuese

Ngritja e njohurive për LPK dhe pasojat

- Seancat trajnuese dhe bashkëbiseduese të cilat janë udhëhequr nga Peer support ku është diskutuar për lëndimet spinale dhe pasojat e lëndimeve spinale
- **Shoqërimi dhe shkëmbimi i përvojave në mes të personave me LPK**
 - Vetëdijesimi i për lëndimin dhe inkontinencën për LPK-në

Me të arritur në vendin e caktuar për kamp është bërë akomodimi i pjesëmarrësve, pas darkës në oborrin e hotelit i caktuar për kamp është bërë prezantimi i të gjithë pjesëmarrësve radhazi, një numër nga ta e ka shpalosur përshtypjet nga kampet e viteve të kaluara .

Gjatë ditëve më radhë janë mbajtur takime në mes të personave me LPK për pasojat e lëndimit dhe inkontinencën ku personat me LPK kanë shprehur përvojat e tyre si ju ka ndodhur lëndimi , me çfarë problemesh janë përballë , si i kanë kaluar problemet e lart cekura të cilat kanë qenë përvoja të cilat ju kanë hy në punë personave të cilët kanë probleme të njëjta .

Janë mbajtur dy seanca grupore ku janë trajtuar temat për lëndimin e boshtit kurrizor dhe pasojat urologjike .

- Përdorimi i karrocës (Pika e ekuilibrit , Manovrimi me karrocë, tejkalimi i
- barrierave arkitektonike, aktivitetet sportive)

- Ushtrimet e mëngjesit (gjimnastika)

Gjatë periudhës së kampit në çdo mëngjes janë mbajtur ushtrimet e mëngjesit të cilat kanë pasur për qëllim relaksim e trupit si dhe fitimin e shkathtësisë për qëndrim stabil në karrocë .Pas ushtrimeve të mëngjesit është bërë (manovrimi me karrocë ,pika e ekuilibrit dhe tejkalimi i barrierave arkitektonike).Prej 10 pjesëmarrësve të cilët nuk kanë pasur njohuri për manovrimet me karrocë 8 prej tyre e kanë mësuar pikën e ekuilibrit kurse 3 nga ta kanë mësuar tejkalimin e barrierave arkitektonike .



- Garat me karroca

Në këtë kamp janë mbajtur gara me karroca në të cilat janë organizuar prej vendit se ku janë mbajtur ushtrimet e mëngjesit e deri te hoteli pikërisht vendi ku janë mbajtur aktivitetet tjera .Garat tjera kanë qenë :sllallomi me karroca ,garë me qifte ,grim me stafet ,lëvizje mbrapa me karrocë .

- Transferet

Gjatë kohës së ushtrimeve janë demonstruar edhe transferet nga karroca në karrige dhe anasjelltas,nga karroca në shtrat dhe anasjelltas si dhe karrocë tokë dhe anasjelltas. Gjatë demonstrimeve të transfereve nga pirsat,10 persona të cilët nuk kanë pasur njohuri për këtë aktivitet,të gjithë kanë arit ti përvetësojnë transferet nga karroca në karrige dhe anasjelltas dhe karroca shtrat anasjelltas ndërsa dy prej tyre kanë arit që të aftësohen me transferim nga karroca në tokë dhe anasjelltas.




- Përdorimi i karrocës në teren të papërshtatshëm

Në një rën prej ditëve të qëndrimit në kamp është organizuar edhe një shëtitje në teren të papërshtatshëm ku pjesëmarrësit e kampit janë përballur me teren të rërës, baltës dhe pengesave të ndryshme gjatë rrugës, ku disa prej tyre përballen me këso kushte në jetën e përditshme ndërsa nuk kanë qenë në njohuri se mund ti përballojnë edhe teren të tilla për deri sa nuk është mbajtur edhe ky aktivitet.



- Loja e Basketbollit

Njëra prej aktiviteteve atraktive ka qenë loja e basketbollit në karroca. Personat të cilët nuk



kanë paramenduar se mundë të zhvillohet një aktivitet i këtillë, janë përballë me realitetin dhe të kënaqur që ende mund ti zhvillojnë aktivitetet si më parë.



- Loja ndërmjet dy zjarreve

Është njeri ndër aktivitete në të cilin kanë marrë pjesë të gjithë shfrytëzuesit e karrocës, dhe ka lanë përshtypje të mira .

- Loja e Shahut

Loja e shahut është organizuar pothuaj se çdo mbrëmje, ndërsa sistemi garues është organizuar dy ditë radhas ku gjithsejtë kanë qenë 11 garues, ditën e parë janë luajtur lojërat eliminatorë ndërsa ditën e dytë është organizuar gjysmë finalja dhe finalja. Në finale janë takuar Musli Xhoxhaj dhe Burim Rashiti. Fitues i këtij turniri ishte Burim Rashiti.



- Loja e pingpongut

Ky aktivitet sportiv është zhvilluar në sistemin eliminues pjesëmarrës në këtë garë kanë qenë gjithsejtë 12 garues. Vendi i parë i takoj pjesëmarrësit ma të rri në kamp Rinor Gashi



• Argëtimi

- Mbrëmje argëtuese

Gjatë periudhës së kampit janë mbajtur dy mbrëmje argëtuese , në mbrëmjen e parë përveç tjerash kemi bërë zgjedhjen e bukuroshes së konkurrencë kanë qenë gjashtë pjesëmarrëse , ku juria e përbërë nga pesë anëtarë për mis kampi shpalli 18 vjeçaren Iliriana Kabashi nga Suhareka .



- Mirëmbajtja e paisjeve ortopedike

Pasi që ka pasur përdorues të mjeteve ndihmëse lëvizëse (Karroca, paterica),kemi pasur me vete edhe logjistikën gjegjësisht personin përgjegjës për mirëmbajtjen e karrocave.



Kujdesi mjekësor

Gjatë 10 ditëshit të qëndrimit në kampin e rehabilitimit aktiv, kujdesi mjekësor ka qenë permanent dhe në çdo kohë. Staf mjekësor kanë qenë të angazhuar një mjeke dhe një teknike medicinale. Problemet e pjesëmarrësve ishin të njëjtat si edhe tek personat të cilët ishin pjesëmarrës viteve tjera. Problemet më të shpeshta ishin:

- Djegia nga dielli (4 persona)
- Plagë nga shtypja gjatë udhëtimit dhe qëndrimit në kamp (5 persona)
- Lëndime serioze që kanë kërkuar intervenime serioze (3 persona)
- Infeksione urinare dhe dehidrim (4 persona)
- Si dhe probleme me ftohje dhe temperaturë



- Përshtypjet dhe Vërejtjet nga pjesëmarrësit

1. Përshtypjet nga ky kamp janë shume te mira sidomos njohja me shoke te ri, gjatë qëndrimit në këtë kamp na mundëson që shoqërimin ta vazhdojmë edhe masë këtij kampi. Gjatë njohjes së problemeve te njëri tjetrit kemi marr informata te cilat nuk i kemi ditur ma pare. Të gjitha aktivitetet kanë qenë ne nivel dhe kanë pasur efektin e vet.

2. Ditët e kënaqësisë ne Ulqin

Kur jam nis për Ulqin mu ka dukë tepër vështir një ndjenje e çuditshme nuk e kam njoftoë gati askënd dhe shumë jam mërzit ditët e para te qëndrimit në kamp...

...Prej te gjitha aktiviteteve që kanë qenë te rëndësishme për mua ma interesante kanë qenë garat me karroca, sllallomi, basketbollli me karroca, si dhe gjatë ndejave te ndryshme humori qe ndodhke ne atë ambient

3. organizimi ka qenë shumë i mirë andaj ka shumë lëvdata nga unë si shoqërues si dhe nga prindi qe është person me LPK ndoshta ka vend për ndonjë kritik te vogël sidomos mospjesëmarrja masive e personave me LPK në pingpong dhe shah kurse nga ana e prindit ka qenë çdo gjë ne nivel vlen te ceket ndihma e te gjithëve për te gjithë faleminderit për te gjithë ata qe organizuan këtë kamp, faleminderit për te gjithë ata që ndihmuan ne shumë raste njeri tjetrin